



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:225844  
Datë: 15.04.2024  
Numri i dokumentit: 05571007

**Në çështjen juridike të :** **AC-I-22-0640-A0001**

**Sh N, Gllogoc.**

*Paditës/Ankues*

**Kundër:**

*E paditura*

**Bank-kos-Banka Themelore** (në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimi të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-7625, të datës 15 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 prill 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e paditësit, refuzohet si e pa bazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-7625, të datës 15 nëntor 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 23 dhjetor 2014, paditësi e kishte paraqitur një parashtrësë në DHPGJS me titullin “Përgjigje”, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN125-0959 të datës 13 shkurt

2015, me të cilin vendim, kërkesa e paditësit për kompensim nga qiraja në shumën prej 21,600.00 euro për periudhën nga viti 2002 deri më 2012 është e pamjaftueshme për të mundësuar shqyrtimin dhe miratimin e saj. Duke qenë se informatat janë të pamjaftueshme për të mundësuar përfshirjen e saj në çfarëdo shpërndarje të të ardhurave të likuidimit, kërkon nga paditësi të dorëzoj kontratën e qirasë me N.SH “Banka Themelore e Kosovës – Bankkos”, për periudhën për të cilën kërkon kompensim, bazën ligjore ose kontraktuale në të cilën ë mbështetë kërkesën e tij për kompensim, vendimin e lëshuar nga DHPGJS për padinë e datës 24 prill 2013, për realizimin e kërkesës dhe çdo dokument ose shpjegim që mund të mbështetë ankesën e tij.

Paditësi në përgjigje kishte propozuar që të aprovohet kërkesa e tij si e bazuar dhe t’i kompensohen mjetet e tij aq sa i takojnë me ligj dhe të ndahen si të gjithë punëtorëve tjerë. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur këto prova: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN125-0959 të datës 13 shkurt 2015, kopjen e librezës së punës, historikun e llogarisë bankare, një shtojcë të kontratës garantuese të datës 15 shkurt 2000, Raporti Federal Zvicëran i Financave i datës 25 gusht 1999, një Marrëveshje ndërmjet Bankkos dhe Zyrës Federale për Ndërtim dhe Logjistikë në Bern, një Marrëveshje mbi qira ndërmjet Bankkos dhe Banka e Re e Kosovës “BRK” nr. 51 e datës 1 janar 2005 si dhe një Aneks i marrëveshjes mbi qira nr. 51 e lidhur me datë 1 janar 2005.

Me datë 4 dhjetor 2014, Kolegji i shkallës së parë të DHPGJS-së me Aktvendimin C-II.-13-0125-C0001 kishte pezulluar procedurën në këtë çështje për arsye se Bankkos ishte në likuidim. Ky pezullim do të mbetet në fuqi derisa të nxjerrët një vendim tjetër gjyqësor për shfuqizimin e pezullimit.

Me datë 16 mars 2022, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se e njëjta e kundërshton në tërësi si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e kërkesës. Pala kundërshtare i ishte përmbajtur qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit kishte kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore. AKP-ja kishte konsideruar se në bazë të dispozitave të mësipërme një kërkesë monetare e çfarëdo lloji që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi dhe që e ka burimin nga marrëdhënia kontraktuale midis dy palëve duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit, pra më së voni tre vjet nga ndërprerja e kësaj marrëdhënie në dhjetor 1990. Duke pasur parasysh të lartcekurat i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur:

vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN125-0959 të datës 13 shkurt 2015 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 15 gusht 2022, paditësi kishte paraqitur një kundërpërgjigje në mbrojtje të AKP-së në të cilën i kishte përsëritur pretendimet e saj dhe i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit ashtu që të detyrohet e paditura që t'i paguaj paditësit pagat mujore nga qiraja e objektit të bankës prej vitit 2002 deri në vitin 2012 deri në privatizimin e saj nga AKP-ja në shumën prej 21,600.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive.

Kundërpërgjigjes i kishte bashkëngjitur një autorizim për përfaqësim, historikun e xhirollogarisë bankare, një dokument identifikimi i paditësit i lëshuar nga Republika e Sllovenisë, kopjen e librezës së punës, një Aktvendim të lëshuar nga Republika e Serbisë, Fondi për Punësim i Kosovës dhe Metohisë me nr. 64 i datës 31 janar 1994.

Me datë 14 tetor 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin nga i cili kishte kërkuar që në afat prej 7 ditëve të dorëzoj në DHPGJS të dhënat dhe dëshmitë me shkrim se me cilën datë dhe me cilin akt i është shkëputur paditësit marrëdhënia e punës si dhe prova shtesë në mbështetje të kërkesëpadisë.

Me datë 28 tetor 2022, paditësi duke iu përgjigjur urdhrorit të lartcekur të gjykatës kishte dorëzuar në DHPGJS një letër konfirmim të lëshuar nga AKP, të datës 24 tetor 2022, kopjen e librezës së punës së paditësit, si dhe një Aktvendim të lëshuar nga “Bankkos” me nr. 430 të datës 4 janar 1988.

Me datë 15 nëntor 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-7625 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vërtetuar kështu vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi theksohet se në rastin konkret gjykata pas shqyrtimit të dosjes së lëndës kishte ardhur në përfundim se nga faktet e treguara apo të prezantuara nga pala paditëse në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë. Përkundrazi bazën e të gjitha fakteve siç i ka prezantuar pala paditëse në padi rezulton se kërkesëpadia nuk është e bazuar. Në vlerësimin e kësaj çështje kontestimore, gjykata kishte vlerësuar se paditësi nuk ka të drejtë të kërkoj paga për një periudhë në të cilën nuk ka qenë në marrëdhënie punë, nuk ka marrë pjesë në procesin e punës dhe nuk ka marrë pjesë në krijimin e fondit të përbashkët të ndërmarrjes, një pjesë e të cilit fond pastaj do ti dedikohet shpërndarjes së të ardhurave personale-pagave të punëtorëve. Paditësit i kishte

pushuar marrëdhënia e punës në vitin 1990 dhe ai do të gëzonte të drejtën në të ardhura personale në ndërmarrje në periudhat e mëvonshme vetëm sikur të kishte kthyer statusin e punëtorit të ndërmarrjes dhe sikur të ishte angazhuar në procesin e punës. Kjo nga arsyeja se paga është rezultat i punës së punëtorit të punësuar në ndërmarrje. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë, gjykata kishte vendosur si më lartë.

Me datë 24 nëntor 2022, paditësi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë ndaj Aktgjykimit C-IV-14-7625 të datës 15 nëntor 2022, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të miratohet ankesa e ankuesit, të anulohet vendimi i të paditurës PRN125-0959 i datës 13 shkurt 2015, të detyrohet e paditura AKP dhe Autoriteti i Likuidimit që paditësit në emër të kompensimit nga qiraja e objektit që i ka realizuar N.SH “Bankkos” t’ia paguaj shumën prej 21,600.00 euro për periudhën nga viti 2002 e deri në vitin 2012.

Gjithashtu të detyrohet e paditura t’ia kompensoj paditësit kamatën prej 10%. Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë gabimisht e kishte aplikuar të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sepse objekti i kërkesëpadisë ka qenë pagesa e qirasë për objektin e dhënë me qira e në këtë rast nuk ka të bëj fare me marrëdhënie pune. Gjykata e shkallës së parë në rastin konkret kishte dalë jashtë kontestit, respektivisht jashtë objektit të kërkesëpadisë sepse paditësi nuk ka kërkuar pagesën e të ardhurave personale apo ndonjë pagesë që është e lidhur me të ardhurat personale nga marrëdhënia e punës, mirëpo i njëjti ka kërkuar pagesën e të ardhurave nga qiraja që i ka realizuar N.SH-ja e të cilën edhe ish punëtorët-kolegët e tij i kanë realizuar nga kjo e drejtë. Gjithashtu ankuesi thekson se aktgjykimi i ankimuar është marrë edhe në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188, al 2, nga fakti se në arsyetimin e aktgjykimit ka theksuar se paditësi ka kërkuar kompensimin e pagave mujore nga marrëdhënia e punës për periudhën kohore nga viti 2002-2012 e jo pagesën e të ardhurave nga qiraja që i ka realizuar N.SH “Bankkos”, ndërsa në fund të arsyetimit të aktgjykimit, këtë çështje e kishte lidhur me marrëdhënien e punës edhe pse kërkesëpadia nuk ka të bëj fare me marrëdhënie të punës por më pagesë të qirasë.

Me datë 28 mars 2024, AKP-ja dorëzon një përgjigje ndaj ankesës së paditësit. Në këtë përgjigje AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë në DHPGJS-ë. Tutje AKP-ja pohon se paditësi nuk ka paraqitë ndonjë bazë juridike të besueshëm dhe as nuk ka mundur të konstatoj një gjendje tjetër faktike

nga ajo që është vërtetuar me Aktgjykimin e ankimuar. Nga këto arsye AKP-ja kërkon nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHPGJSK), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Meritat e ankese dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i gjyqtarit të shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin nga qiraja në shumë prej shumë prej 21,600.00 euro për periudhën nga viti 2002 deri më 2012 është refuzuar si e pavlefshme, me arsyetimin se marrëdhënia e punës së tij ishte ndërpre më 1990. Ndërsa punëtorët e punësuar në institucione tjera nuk janë paguar nga këto mjete.

Shkallës e parë të DHPGJS-së e kishte refuzuar padinë e paditësit me arsyetim se i njëjti nuk kishte arsyetuar me ndonjë fakt apo provë të vlefshme me të cilat, kërkesë padia e paditësit do të mund të konsiderohet si e themeltë.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së pas shqyrtimit të shkresave të lëndës kishte vërejtur se paditësi së bashku më ankesën e tij të ushtruar ndaj vendimit PRN125-0959 të datës 13 shkurt 2015, kishte parashtruar edhe kopjen e librezës së punës, historikun e llogarisë bankare, një shtojcë të kontratës garantuese të datës 15 shkurt 2000, Raporti Federal Zvicëran i Financave i datës 25 gusht 1999, një Marrëveshje ndërmjet Bankkos dhe Zyrës Federale për Ndërtim dhe Logjistikë në Bern, një Marrëveshje mbi qira ndërmjet Bankkos dhe Banka e Re e Kosovës “BRK” nr. 51 e datës 1 janar 2005 si dhe një Aneks i marrëveshjes mbi qira nr. 51 e lidhur me datë 1 janar 2005.

Kolegji i Apelit konsideron se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë se ishte në marrëdhënie pune në NSh. në periudhën për të cilën i kërkon kompensimin për qira. Sipas Librezës së Punës e mbyllur më datën 14/12/1990 rezulton se të njetit nga kjo datë i ka

përfunduar marrëdhënia e punës. Në bazë të Librezës së punës, paditësi nga kjo datë nuk ishte punëtor i NSh-së në fjalë andaj edhe pretendimi i tij për kompensimi për qira për periudhën e cekur me lartë nuk është i bazuar .

Nga faktet e paraqitura si dhe ,nga provat e gjetura në shkresat e lëndës nuk mund të gjendet ndonjë kërkesë apo provë me të cilën mund të vërtetohet se paditësi kishte ankimuar kishte kontestuar largimin e tij nga puna në vitin 1990 para ndonjë organi administrativë apo gjykatë.

Për më tepër sipas thënieve të AKP-së të punësuarit në ndonjë institucion tjetër si dhe ata të cilët nuk janë lajmëruar në punë nuk kanë pasur të drejtë të paguhen nga këto mjet. Përderisa paditësi sipas librezës së punës ishte i punësuar në nga 01/01/ 1994 deri më 31 /01/1998 në Shoqatën, PKF, Glllogoc .

Barra e provës sipas nenit 42. 2 të Ligjit për DHPGJS, për të vërtetuar një fakt bie mbi paditësin. Paditësi përkundër provave të lartcekura të cilat ndodhen në shkresa të lëndës, nuk ka vërtetuar faktin se me ndonjë veprim të AKP-së, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se ishte në marrëdhënie pune për periudhën për të cilën kërkon kompensimin.

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e parë e DHPGJS-së ka vepruar drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, pasi që të njëjtit në mungesë të provave nuk mund t'i njihet e drejta në kompensim.

Prandaj nga këto arsye në bazë të nenit 9,10 ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore më 13 dhjetor 2022 për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 12 prill 2024.

Mr.sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_